

Në kafe-librarinë "Dit' e nat'" u promovua romani i gazetares Klara Buda

"Kloroform", pasqyra e Shqipërisë së viteve '80

ELVIRA BERISHA

PRISHTINË, 4 MAJ- "Diktatura nuk kursen askënd" është mesazhi që autorja shqiptare, Klara Buda, përcjell në romanin të saj "Kloroform".

Libri, i cili është botuar para disa muajsh në Shqipëri, të martën është promovuar në kafe-librarinë "Dit e nat".

"Kloroform" është një fiksjon që shtrihet në vitet '80 dhe mëton të japë një pasqyrë më ndryshe rreth asaj që ka ndodhur në Shqipëri, në atë periudhë kohore.

Me rastin e promovimit të librit, autorja Klara Buda, e cila është edhe gazetare që vepron në Paris, ka shpalosur dëshirën që libri i saj i parë të promovohet edhe në Kosovë.

"E ndjej si detyrim ndaj gjuhës, kulturës e vetë Kosovës", ka thënë ajo. Buda nuk ka hezituar të zbërthejë "brumin", i cili i kishte shërbyer për të ndërtuar rrëfimin e romanit.

"Është një fiksjon që trajton idealin e lirisë. Personazhet e këtij libri nuk kanë



grupe për të luftuar por janë njerëz të thjeshtë të cilët kanë vetëm një aspiratë: të jetojnë jetën e tyre të lirë dhe secili prej tyre krijon ishuj lirie në shpirtin e vet në kuptimin abstrakt për t'i rezistuar kësaj diktature", ka shpjeguar Buda.

Gazetari Augustin Palokaj, ka bërë një rezymë të biografisë së autores Klara Buda.

Duke "kapërcyer" nëpër vite për të dhënë

një pasqyrë të veprimtarisë së Budës si gazetare, Palokaj është ndalur edhe të romani.

"Prek një temë mjaft të guximshme por duhet të ndalim praktikën e të befashuarit. Nuk duhet befashuar pse prekim një temë", ka thënë Palokaj. "I uroj Karlës për këtë roman dhe e di që ka qenë e guximshme, por duhet ta përmend se ajo në Paris ka qenë një aktiviste për Shqipërinë e më shumë edhe për Kosovën", ka shtuar ai.

Publicisti Beqë Cufaj, po ashtu e ka çmuar guximin e Budës për të ofruar një perspektivë tjetër të Shqipërisë së viteve '80. "Mund të them se është një përshkrim shumë me mjeshtëri dhe shumë i guximshëm i një autoreje shqiptare, që rrallëherë mund të haset në letrat shqipe", ka vlerësuar Cufaj.

Ndryshe, Klara Buda është gazetare shqiptare, e cila jeton në Paris. Që nga viti 2006 është shefe e shërbimit të gjuhës shqipe në "Radio France Internationale" (RFI) në Paris.